

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës z. Burim Berisha**

I nderuari z. Berisha,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shprehur që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin tuaj të mbajtur në “Jeta në Kosovë”, ju keni premtuar:

- Investime kapitale me vlerë mbi 1 milionë euro në arsim, 500 mijë euro në shëndetësi dhe 700 mijë euro në rini, kulturë e sport;
- Investime në vlerë 1,1 milion euro për ndriçim në lokalitete dhe parqe;
- Investime në vlerë 1,3 milion euro në infrastrukturën rrugore;
- Investime në vlerë 700,000 euro në trotuare dhe rindërtime;
- Rishqyrtimin e zgjerimit të rrugës për aeroport dhe vendosjen e zebrave;
- Furnizimin me ujë të pijshëm për 24 orë në gjithë Fushë Kosovën, në vitin 2010;
- Investimet me vlerë 700,000 euro për përmirësimin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Rindërtimin e fabrikës së ujit në Kuzmin, e cila do të shtoj kapacitetin e ujit;
- Ndërtimin e fushave të reja sportive;
- Investimet në sport, me vlerë 200,000 euro;
- Ndërtimin e palestrës sportive dhe 4 fushave të sportit të vogël në Bardh të Madh
- Ndërtimin e shkollës në Nakaradë;
- Investimet me vlerë 500,000 euro në pyllëzim dhe pastrim;
- 400,000 euro ndihmë për agrobizneset;
- Ndërtimin e 2 çerdheve të reja me 150 fëmijë (plus 2 në fshatrat Bardh dhe Miradije me nga 50 fëmijë);

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)